



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 4127/1 prot.

Tiranë, më 12.01. 2026

Lënda: Kërkohet shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2025.

Drejtuar: KONFERENCËS SË KRYETARËVE

KËTU

I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar Anëtarë të Konferencës së Kryetarëve,

Në datën 4 Nëntor 2025, Komisioni European publikoi Raportin e tij për Shqipërinë për vitin 2025, i cili në kuadër të vlerësimit të përmbushjes së detyrimeve nga Shqipëria analizon ndër të tjera, për grupkapitullin e parë "Themelorët" edhe nën pikën që lidhet me funksionimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Përmbushja e sfidave, detyrimeve dhe reformave të nevojshme, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin European kanë si domosdoshmëri rritjen e vazhdueshme të rolit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim përqasjen me standardet me të mira ndërkombëtare të shtetit të së drejtës dhe të drejtave e lirive të njeriut, përmirësimin e dialogut politik, rritjen e mbikëqyrjes ndaj qeverisë, monitorimin ndaj institucioneve të pavarura etj.

Në rregulloren e Kuvendit, Neni 103/4 "*Plani i veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të BE-së*" në pikën 1 dhe 2 përcaktohet: "*1. Konferenca e Kryetarëve, çdo vit, miraton planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit European. 2. Plani vjetor i veprimit për integrimin european pasqyron gjetjet, rekomandimet dhe sfidat e identifikuar në raportin e progresit të Komisionit European për Shqipërinë, për kriterin politik/Kuvendin, si dhe masat konkrete që duhet të merren për realizimin e objektivave të Kuvendit.*" Bazuar në këto dispozita, stafi administrativ i Kuvendit ka analizuar Raportin e Komisionit European për vitin 2025 dhe ka hartuar Draft Planin e Veprimit 2025 për zbatimin e rekomandimeve të dhëna specifikisht për Kuvendin dhe përmirësimin e performancës së tij, të cilin e gjeni bashkëlidhur.

Draft Plani i Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2025 aktualisht është i ndarë në 5 objektiva kryesore:

I. Forcimi i funksionit ligjvënës të Kuvendit;

- II. Forcimi i funksionit mbikëqyrës dhe monitorues të Kuvendit;
- II. Forcimi i funksionit zgjedhës;
- V. Forcimi i efektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies së Kuvendit;
- V. Përmirësimi i etikës parlamentare.

Secili nga objektivat është trajtuar në 5 elemente: 1) Gjetjet/ rekomandimet e Raportit të KE-së për Shqipërinë 2025 lidhur me Kuvendin; 2) Masat konkrete që propozohen për adresimin e gjetjeve/ rekomandimeve; 3) Struktura përgjegjëse për zbatimin e masave të propozuara; 4) Buxheti dhe efekti financiar i masave të propozuara dhe 5) Afatet kohore brenda të cilave duhet të zbatohen masat e propozuara. Ky dokument përbëhet nga 23 masa dhe 13 nënmasa.

Draft Plan i Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2025 iu është shpërndarë paraprakisht për mendim, komisioneve të përhershme parlamentare, me shkresën e Kryetarit të Kuvendit nr. 4217 Prot, datë 17.12.2025.

Miratimi i këtij dokumenti, do t'i shërbejë Kuvendit si një udhëzues për të planifikuar dhe zbatuar masat e nevojshme me qëllim arritjen e standardeve të kërkuara.

Sa më sipër, lutem gjeni për shqyrtim dhe miratim, Draft Planin e Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2025.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ



Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifiktisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

OBJEKTIVI I: FORCIMI I FUNKSIONIT LIGJVËNËS TË KUVENDIT					
Total 8 masa					
Gjeje/Rekomandime të Raportit 2025 të KE për Shqipërinë lidhur me Kuvendin.	Masa konkrete	Struktura përgjegjëse	Buxheti / Efekti financiar shtesë	Afati kohor	Statusi i realizimit të masave
Përfundimet paraprake të misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të (OSBE) / (ODIHR) vunë në dukje se zgjedhjet ishin konkurruese dhe të zhvilluara në mënyrë profesionale, por identifikuan disa mangësi, duke përfshirë mungesën e garës së barabartë dhe abuzimin me burimet publike. Reforma e pjesshme zgjedhore ndryshoi Kodin Zgjedhor, por nuk arriti të adresojë një numër rekomandimesh të hershme nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias. Nevojitet një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse. (Gjejet kryesore të Raportit, fq 3-4)	1.1 Miratimi i ndryshimeve në kadrin ligjor (Kodin Zgjedhor dhe ligjin për financimin e partive politike) përmes një konsensusi të gjerë ndërpartiak, procesi konsultues të hapur dhe gjithëpërfshirës që adreson të gjitha vendimet përkatëse në prirje të Gjykatës Kushtetuese, rekomandimet e padoresuara të OSBE/ODIHR, Komisionit të Venecias dhe Komisionit European.	Komisioni i Posaçëm i reformës zgjedhore Shërbimi Legjislativ, Instituti Parlamentar Shërbimi i Integritetit European	Buxheti i Kuvendit & donatorët	Nëntor 2025 - Korrik 2026	
Kodi Zgjedhor u ndryshua në korrik 2024 dhe shkurt 2025, duke iu përgjigjur pjesërisht vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe u					

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifkisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

reflektua në zgjedhjet parlamentare të majit 2025: <i>ndryshimet mundësuan votimin jashtë vendit, ndryshuan sistemin e votimit preferencial, rritën kufijtë e shpenzimeve të fshatës, modifikuan afatet zgjedhore dhe trajtuan kohën e transmetimit për kandidatët. Megjithatë, nevojiten ndryshime të mëtejshme në kuadrin zgjedhor për të adresuar rekomandimet e paadresuara të OSBE/ODIHR-it dhe për t'u përfaqësuar më tej me standardet demokratike.</i>				
Përfundimet paraprahe të misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të OSBE/ODIHR treguan se zgjedhjet ishin konkurruese dhe të zhvilluara profesionalisht, por u zhvilluan në një mjedis shumë të polarizuar dhe garuesit nuk gëzonin kushte të barabarta. Megjithatë, kandidatët ishin përgjithësisht në gjendje të zhvillonin fushatat e tyre lirisht. Përfshirja e votimit jashtë vendit u menaxhua mirë dhe u konsiderua gjerësisht si një zhvillim i rëndësishëm zgjedhor.				

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifiktisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

SPAK miratoi një strategji për të betuar korruptionin zgjedhor. Mekanizmi i ri i koordinimit midis SPAK, KQZ dhe Zyres së Prokurorit të Përgjithshëm çoi në një shkëmbim më të mirë informacioni mbi krimet zgjedhore dhe u pa si një efekt i mundshëm parandalues.					
<i>Ndryshime të kufizuara në financimin e fushatës janë miratuar që nga viti 2020, me rekomandimet kryesore të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias që mbetën të paadresuara. Edhe pse shumica e partive politike nënshkruan një kod sjelljeje vullnetar për fushatat dixhitale para fushatës, disa garrues ndanë përmbajtje përcarëse, diskriminuese dhe manipuluese. Përpjekjet e monitorimit mbetën të kufizuara në fushëveprim dhe efektivitet. U vunë re gjithashtu zhvillime shqetësuese, veçanërisht fakti që partia në pushtet përfitoi nga përdorimi i gjerë i burimeve administrative dhe ndikimit institucional, si dhe shqetësimet në</i>					

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifiktisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

<i>lidhje me ndikimin e rrjetëve të patronazhimit.</i>				
<i>Gjatë zgjedhjeve parlamentare, 787 kandidatë femra kandiduan për një vend në Parlament (38.47% e të gjithë kandidatëve). Ndërsa ky është një zhvillim pozitiv, misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it theksoi stereotipet e vazhdueshme gjinore dhe retorikën diskriminuese kundër grave politikisht aktive si pengesa të rëndësishme për pjesëmarrje. Pas zgjedhjeve, gratë mbeten të nën-përfaqësuara në Parlament, duke mbajtur 51 nga 140 vendet. Korriza aktuale ligjore në lidhje me financimin e partive politike nuk është efektive për shkak të mungesës së një kufiri maksimal për shpenzimet e kandidatëve dhe mungesës së një rregulloreje të qartë mbi reklamat. (Grupkapitulli I: Bazat e procesit të amëtarësimit; Demokracia / Zgjedhjet/, fq 21-22)</i>				

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifikkisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

<i>Parlamenti dështoi të zbatojë disa vendime të Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të caktuar. Në një opinion mbi këtë qështje, Komisioni i Venecias konfirmoi se vendimet e Gjykatës Kushtetuese ishin të detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, përfshirë Parlamentin. Parlamenti ende nuk e ka vepruar mbi këtë opinion të Komisionit të Venecias. (Grupkapitulli I: Bazat e procesit të anëtarësimit/Demokracia / Parlamenti, fq. 22)</i>	1.2 Shqyrtimi dhe zbatimi i Vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga Këshilli për Legjislacionin dhe Seanca plenare - Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”	Këshilli për Legjislacionin Seanca Plenare Shërbimi Legjislativ	Buxheti i Kuvendit.	Nëntor 2025 - e në vijim	
Reforma në drejtësi e vitit 2016 ka forcuar pavarësinë e Këshillave. Megjithatë, mangësitë e konstatuara më parë vazhdojnë të mbeten në lidhje me emërimin e anëtarëve jo-magjistratë në KLGJ dhe KLP. Ata nuk i nënshtrohen të njëjtave standarde si anëtarët magjistratë për verifikimin e figurës dhe të pasurisë, gjë që ndikon në transparencën dhe meritokracinë e procesit.	1.3 Shqipëria vijon edhe më tej finalizimin progresiv të reformës brenda vitit 2025, përfshirë ndryshimeve ligjore l: - Sigurimin e pakthyeshmërisë së rezultateve pozitive të procesit të rivlerësimit duke përforcuar normat për kontrollin e pasurive dhe figurës për aktorët kryesorë të sistemit të drejtësisë	Deputetët Komisionet parlamentare sipas fushës së përgjegjësisë Shërbimi legjislativ Shërbimi i Integrimit European Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura	Buxheti i Kuvendit.	Nëntor 2025 - e në vijim	

¹ Masë e marrë nga Kuvendi në kuadër të Udhërrëfysit për Shtetin e së drejtës, miratuar me VKM nr. 736, datë 13.12.2023 si dhe Reformës së Ashtendës me BE &

Drafti Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifikkisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

Ndërsa qëndrueshmëria e gjyqësorit është përmirësuar, përpjekjet e zyrtareve publikë ose politikanëve për të ushtruar ndikim dhe presion të panevojshëm janë shtuar, duke ngritur shqetësime serioze, veçanërisht reagimet publike të paprecedentë dhe përpjekjet për të ushtruar presion nga ekzekutivi dhe legjislativi kundër Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD).				
Vazhdon të ketë sfida në lidhje me bërijen terheqës të pozicionit për magistratë-inspektorë në ILDKP dhe ende priten ndryshime ligjore për të adresuar çështjen.	- Masave që sigurojnë efikasitet;			
	- Ndryshimi i dispozitave ligjore ² që rregullojnë përzgjedhjen e anëtarëve jomagjistratë të KLGJ-së dhe KLP-së, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për t'iu përshatur standardeve të larta të integritetit, kontrollit të figurës dhe deklaratës së pasurisë, të zbatueshme për magistratët, si edhe për të siguruar zbatimin sa më të plotë të parimit të bazuar në meritë për renditjen e pavarur.			
Vazhdon të ketë sfida në lidhje me bërijen terheqës të pozicionit për magistratë-inspektorë në ILDKP dhe ende priten ndryshime ligjore për të adresuar çështjen.	- Ndalinjt të përfshijes së ish-magjistratëve të shkarkuar/dorëhequr gjatë procesit të rivlerësimit në veprimtaritë e institucioneve të qeverisjes së drejtësisë			
	- Forcimit të kapaciteteve të Shkolles së Magjistraturës			
Vazhdon të ketë sfida në lidhje me bërijen terheqës të pozicionit për magistratë-inspektorë në ILDKP dhe ende priten ndryshime ligjore për të adresuar çështjen.	- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 96/2016			

² Masë e marrë në kuadër të Dokumentit të Politikës “Agjenda e Reformave 2024-2027” miratuar me VKM nr.621, datë 10.10.2024

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifiktisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

<i>Ende duhet të miratohet legjislacioni për të ndaluar magistratët e verifikuar ose magistratët me një ndalim 15-vjeçar nga poste të larta gjyqësore të marrin pozicione si staf trajnimi në Shkollën e Magistraturës.</i>	<i>“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.</i> <i>- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.</i>				
<i>Cilësia gjyqësore pengohet seriozisht nga mungesa e progresit në emërimin e kryetarëve të gjykatave në të gjitha nivelet dhe numri i pamjaftueshëm i stafit të gjykatave, veçanërisht i asistentëve ligjorë.</i>					
<i>KLGG ka miratuar një plan veprimi për efikasitetin, por duhet të ndërmerret hapa të mëtejshëm, duke përfshirë rishikimin e legjislacionit në përputhje me parimet e përgjithshme të reformës në drejtësi dhe standardet evropiane. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar dixhitalizimin e sistemeve të drejtësisë. (Gjeçet kryesore të Raportit, Kapitulli 23/ Funksionimi i Gjyqësorit fq 27-31)</i>					

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifikkisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

Shqetësime u ngritën gjithashtu në lidhje me komisionin parlamentar ad hoc për thellimin e reformave për qeverisje të mirë, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin. U vu re rreziku i dyfishimit me organet e tjera parlamentare që merren me integrimin evropian. <i>Është e rëndësishme që puna e parlamentit në këtë fushë të jetë gjithëpërfshirëse, transparente dhe në përputhje me rezultatet pozitive të reformës në drejtësi të vitit 2016, duke garantuar pavarësinë e institucioneve të drejtësisë. (Grupkapitulli 1. Pika 2.1.1 Demokracia/Parlamenti fq 23)</i>					
Korriza ligjore për luftën kundër korrupsionit është gjerësisht e vendosur, por duhet të përmirësohet në lidhje me masat parandaluese. Janë ndërmarrë disa hapa drejt rishikimit të legjislacionit për konfliktin e interesave, megjithëse legjislacioni kundër korrupsionit mbetet kompleks dhe i paplotë. <i>Legjislacioni i rishikuar për konfliktin e interesave, mbrojtjen e denoncuesve, financimin e partive</i>	1.4 Ligji i ri “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike” .	Deputetët Komisionet parlamentare sipas fushës së përgjegjësisë Shërbimi legjislativ Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura Shërbimi i Integritetit European	Buxheti i Kuvendit dhe donatorët	Nëntor 2025 - e në vijim	
	1.5 Projektligji “Për një shesë dhe ndryshim në ligjin	Deputetët	Buxheti i Kuvendit.	Nëntor 2025 - e në vijim	

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifikisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

<i>politike, lobimin, donacionet dhe sponsorizimet, luftën kundër pashtrimit të parave, kontrollin e brendshëm dhe inspektimin financiar ende duhet të miratohet. Përveç kësaj, legjislati mbi kontaktet me lobistët ende duhet të miratohet. (Gjejet kryesore të Raportit, Kapitulli 23/ Lufta kundër korrupsionit / 27-33)</i>	nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar	Komisionet parlamentare sipas fushës së përgjegjësisë Shërbimi legjislativ Shërbimi i Integritetit European		
Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan dhe mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:	1.6 Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar për dekriminalizimin e “shpifjes” dhe “fyerjes”.	Deputetët Komisionet e Përhershme parlamentare Scanca plenare Shërbimi Legjislativ Shërbimi i Integritetit European Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura	Buxheti i Kuvendit dhe donatorët	Nëntor 2025 - e në vijim
→ miratojë një reformë të kuadrit ligjor dhe rregullator për të: (i) forçar transparencën e pronësive së medieve, pluralizmin mediatic dhe pavarësinë editoriale; (ii) forçar transparencën e financimit të medieve nga burimet private dhe shtetërore; (iii) forçar autonominë e rregullatorit të medias dhe pavarësinë e transmetuesit publik; (iv) <i>shfuqizuar plotësisht dispozitat penale për fyerjen dhe shpifjen</i>; dhe	1.7 Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar			

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifiktisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

(v) përafshuar aspektet civile të shpifjes me standardet evropiane; → sigurojë tolerancë zero ndaj intimidimit dhe zbatim efektiv në rastet e sulmeve ndaj gazetarëve, përfshirë ndjekjen gjyqësore; të sigurojë rritjen e kapaciteteve të organeve të zbatimit të ligjit për trajtimin e rasteve të dhunës, përfshirë protestat, si edhe të çështjeve të tjera penale që përfshijnë gazetarë, veçanërisht duke garantuar një përputhje të lartë me të drejtat e njeriut në trajtimin e incidenteve që përfshijnë gazetarë, përmes udhëzimeve detyruese, mbledhjes së të dhënave dhe masave për ngritjen e kapaciteteve; → përmirësojë kushtet e punës së gazetarëve në Shqipëri, veçanërisht duke forcuar mbrojtjen e punësimit dhe të të drejtave sociale të gazetarëve dhe duke siguruar që Kodi i					
--	--	--	--	--	--

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifikkisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

Punës të zbatohet në mënyrë të qëndrueshme. (Pika. 1.2. Gjetjet kryesore të raportit / Grupkapitulli 1/ Kapitulli 23/ liria e shprehjes fq 7)	Shqipëria nuk bëri përparrim në përqfrimin e kuadrit legjislativ me acquis të BE-së dhe standardet evropiane. Kjo përfshin mungesën e përparrimit për të adresuar sfidat kryesore që pengojnë pavarësinë e medias. Përqendrimi i lartë i tregut dhe mungesa e transparencës së pronësisë së medias, burimeve të financimit dhe intereseve ekonomike, duke përfshirë financimin publik, vazhduan të ndikojnë negativisht në pavarësinë dhe pluralizmin e medias. Pavarësia e Autoritetit Rregullator Audio-Vizuale (AMA) ende nuk është e garantuar pasi potenciali për ndikim politik dhe të korporatave në lidhje me procedurat e emërimit për anëtarët e bordit të AMA-s vazhdon, ndërsa ka pasur mangësi në zbatimin e Kodit të Transmetimit në mediat që transmetojnë përmbajtje politike të				
--	--	--	--	--	--

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifikkisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

<i>regjistruar paraprakisht gjatë fushatave zgjedhore. Parregullsitë procedurale në procesin zgjedhor për një Drejtor të Përgjithshëm të RTSH në janar 2025 minuan më tej parimet e për zgjedhjes bazuar në meritë dhe rritën shqetësimet mbi pavarësinë e RTSH. Në shkurt, Parlamenti shpërndau të gjithë Këshillin Drejtues të RTSH, në shkelje të legjislacionit në fuqi, i cili lejon skuatifikimin individual të anëtarëve të Këshillit Drejtues vetëm në varësi të garancive të procesit të rregullt ligjor. Emërimi i disa anëtarëve të Këshillit të ri, të krijuar në mars 2025, ngriti shqetësime për shkak të prejarthjes së tyre politike. Në prill 2025, bordi i ri zgjodhi Drejtorin e Përgjithshëm të RTSH.</i> Një dialog i strukturuar midis institucioneve shqiptare dhe aktorëve të medias u nis në janar 2025 me qëllim diskutimin e reformave kryesore legislative dhe rregullatore për të rritur lirinë e shprehjes, duke përfshirë lirinë e medias dhe pluralizmin. Pas një					
--	--	--	--	--	--

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifikkisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

prezantimi të rekomandimeve specifike në qershor 2025, puna e platformës është ende në vazhdim. <i>Mbetet thelbësore që Komisioni i Venecias të konsultohet mbi ndryshimet legislative që rezultojnë përpara se ato të miratohen.</i> (Grupkapiulli 1 / Kapiulli 23 / të drejtat themelore dhe liria e shprehjes fq 36-37)					
<i>Korniza ligjore dhe institucionale për mosdiskriminimin është e paplotë dhe kapacitetet e organeve të barazisë duhet të përmirësohen. Janë ndërmarrë hapa të kufizuuar për të përafruar plotësisht kornizën ligjore dhe institucionale për mosdiskriminimin me acquis të BE-së - duke përfshirë barazinë racore dhe standardet për organet e barazisë dhe standardet evropiane.</i>	<i>1.8 Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”</i>	Deputetët Komisionet e Përhërësime parlamentare Komisioni i Dezinformimit Seanca plenare Shërbimi Legjislativ Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavaruara Shërbimi i Integrimit European	Buxheti i Kuvendit.	Nëntor 2025 – e në vijim	

OBJEKTIVI II: FORCIMI I FUNKSIONIT MBIKËQYRËS DHE MONITORUES TË KUVENDIT					
Total 3 masa dhe 13 nënmasa					
II. a FORCIMI I MËTËJSHËM I FUNKSIONIT MBIKËQYRËS TË KUVENDIT NDAJ EKKZEKUTIVIT					
Total 1 masë dhe 7 nënmasa.					
Cjettje/ Rekomandime të Raportit 2025 të KE për Shqipërinë lidhur me Kuvendin.	Masa konkrete	Struktura përgjegjëse	Buxheti/Efekt i financiar	Afati kohor	Statusi i realizimit të masave

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifiktisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

<i>Parlamenti mund të ushtrojë pushtet e tij në një mënyrë pjesërisht efektive. Polarizimi politik, mungesa e dialogut të vërtetë politik dhe përplasjet midis shumicës në pushtet dhe pjesëve të opozitës vazhduan të ndikojnë në aktivitetin e Parlamentit. Parlamenti pengohet gjithashtu nga mbikëqyrja e kufizuar mbi ekzekutivin. (Gjetjet kryesorë të Raportit/ Parlamentit, fq 4)</i> <i>Mbikëqyrja e ekzekutivit nga Parlamenti mbeti e dobët. Shumica e nisimave legislative janë paraqitur nga Këshilli i Ministrave.(Grupkapitulli Demokracia / Parlamentit, fq 22)</i> <i>Mbikëqyrja publike i punës së qeverisë është ende e dobët, dhe kontrolli parlamentar i vendimmarrjes së qeverisë mbetet i kufizuar.</i> Dispozitat e ligjit organik të buxhetit ndiqen kryesisht. Megjithatë, rishikimet e buxhetit ende kryhen ekskluzivisht përmes akteve normative të miratuara nga ekzekutivi. Nevojiten veprime më vendimtare për t'u rikthyer në proceset e rregullta të	2.a.1 Ushtrimi sistematik i funksionit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj veprimtarisë së qeverisë, lidhur me zbatimin e ligjeve dhe politikave, përmes: 2.a.1.a Përdorimit më intensiv të interpelancave, pyetjeve, mocioneve për debat në seancat plenare	Deputetët; Komisionet parlamentare sipas fushës së përgjegjësisë Kuvendi/ Shërbimi legjislativ Shërbimi i Integritetit European	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim	
	2.a.1.b Kërkesave për informacion me shkrim;	Deputetët Sektori i Protokollit	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim	
	2.a.1.c Zhvillimi i vizitave monitoruese;	Deputetët; Komisionet parlamentare sipas fushës së përgjegjësisë Kuvendi/ Shërbimi legjislativ Shërbimi i Integritetit European	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim	
	2.a.1ç Organizimit periodik nga komisionet e përhershme parlamentare të seancave dëgjimore me ministrit dhe me zyrtarë të tjerë të lartë të qeverisë, me qëllim marrjen e informacioneve dhe të shpjegimeve për çështjet që	Deputetët; Komisionet parlamentare sipas fushës së përgjegjësisë Shërbimi legjislativ Shërbimi i Integritetit European	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim	

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifiktisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

rishikimit të buxhetit përmes Parlamentit. (Reforma në administratën publike/menaxhimi i financave publike, fq 25) Shqipëria duhet të vijojë mbi punën fillestare të nënkomisionit parlamentar për auditimin, me një fokus të veçantë në sigurimin e mbikëqyrjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit nga ekspertivë. (Gjetjet kryesore të Raportit /kapitulli 32, fq 10)	lidhen me veprimtarinë e tyre.			
	2.a.1.d Ngritjes dhe funksionimit të Komisioneve hetimore.	Konferenca e Kryetarëve Seanca Plenare Deputetët; Shërbimi legjislativ	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim
	2.a.1.dh Përmirësimi i shqyrtimit të projektligjit për buxhetin e shtetit nga Komisionet parlamentare dhe seanca plenare si dhe shtimi i kontrollit nga Kuvendi/Komisionet parlamentare për mënyrën e zbatimit të ligjit të buxhetit të shtetit.	Komisionet sipas fushës së përgjegjësisë Deputetët; Shërbimi legjislativ Shërbimi i Integritetit European	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim
	2.a.1.e Vijimi i punës së nënkomisionit të auditimit të sektorit publik	Nënkomisioni i auditimit të sektorit publik Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat Shërbimi legjislativ Shërbimi i monitorimit të Institucioneve të Pavarura	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim

II. b FORCIMI I BASHKËPUNIMIT DHE MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifikisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

Total 2 masa dhe 6 nënmasa					
Gjetje/ Rekomandime të Raportit 2025 të KE për Shqipërinë lidhur me Kuvendin.	Masa konkrete	Struktura përgjegjëse	Buxheti /Efekti financiar	Afati kohor	Statusi i realizimit të masave
Vitin e ardhshëm, <i>Shqipëria duhet të mbështetet veçanërisht në punën fillestare të nënkomisionit parlamentar për auditimin, me një fokus të veçantë në sigurimin e mbikëqyrjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit nga ekzekutivi.</i> <i>Gjetjet kryesore të raportit, Kapitulli 32, fq 11)</i> Shqetësime u ngritën gjithashtu në lidhje me komisionin parlamentar ad hoc për thellimin e reformave për qeverisje të mirë, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin. U vu re rreziku i dyfishimit me organet e tjera parlamentare që merren me integrimin evropian. Është e rëndësishme që puna e parlamentit në këtë fushë të jetë gjithëpërfshirëse, transparente dhe në përputhje me rezultatet pozitive të reformës në drejtësi të vitit 2016, duke garantuar pavarësinë e institucioneve të drejtësisë. <i>(Grupkapitulli 1. Pika 2.1.1 Demokracia/Parlamenti fq 23)</i> Ndikimi i punës së auditimit përparoi. 99% e rekomandimeve të lëshuara në	2.b.1 Ushtrimi sistematik i funksionit monitorues të Kuvendit ndaj veprimtarisë së institucioneve të pavarura përmes:	Komisionet parlamentare sipas fushës së përgjegjësisë; Kuvendi/Seancë Plenare; Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim	
	2.b.1.a. Shqyrtimi nga Kuvendi/ Komisionet e përhershme parlamentare, të raporteve vjetore të institucioneve të pavarura, duke zbatuar procedurat dhe afatet ligjore të raportimit në Kuvend që parashikohen në Kushtetutë, Rregulloren e Kuvendit (Neni 103) dhe ligjet organike që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve.	Shërbimi i Komisioneve			
	2.b.1.b Organizimi i takimeve periodike Kuvend-institucione të pavarura-ekzekutiv për zbatimin dhe përditësimin me efektivitet të platformës ndër-institucionale online	Kryetari i Kuvendit; Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim	

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifikisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

auditimet e vitit 2024 u pranuan, nga të cilat 47% u zbatuan plotësisht ose pjesërisht. <i>Shqipëria duhet të përmbështejë zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm.</i> Nënkomisioni parlamentar për auditimin ka mbajtur disa seanca dëgjimore gjatë periudhës raportuese dhe ka nxjerrë rezoluta në lidhje me një numër auditimesh nga Institucioni Suprem i Auditimit të Shetit (KLSH), i cili është një trend pozitiv. Grupkapiulli I/ pika 2.4 /Kapiulli 32, fq 60-61)	<i>për rekomandimet e institucioneve të pavarura ndaj ekzekutivit si dhe rifijen e transparencës së tyre.</i>				
-Zbatimi efektiv i të drejtave të njeriut është sfidues, veçanërisht për të drejtën e pronës dhe të drejtat e fëmijëve. (Kapiulli 23/ të drejtat e njeriut/ Promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut/ fq 34)	2.b.1.c Zbatimi i mekanizmit ndërinstitucional “Qeveri-Kuvend-Institucione të Pavarura”, i miratuar me vendimin e Kuvendit nr.49/2017, për ndjekjen dhe monitorimin sistematik të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushetuese dhe atyre të krijuara me ligj.	Kryetari i Kuvendit; Ministri i Shetit për Marrëdhëniet me parlamentin Institucione të pavarura Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim	
Në përgjithësi, numri më i madh i ankesave të pranuar nga Avokati i Popullit në vitin 2024 kishin të bënin me kufizimin e lirisë personale (295	2.b.1.ç Ndërtimi i Platformës Ndërinstitucionale (programit kompjuterik)	Kryetari i Kuvendit; Ministri i Shetit për Marrëdhëniet me parlamentin Institucione të pavarura Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve	Buxheti i Kuvendit dhe donatorët	Nëntor 2025 - e në vijim	

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifiktisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

aneksa, 16% në përgjithësi). Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit mbetet përgjithësisht i ulët, duke penguar efektivitetin e mbikëqyrjes dhe duke penguar dëshmipërbllimin për shkeljet e të drejtave të njeriut. (Kapitulli 23/ të drejtat e njeriut/ Promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut/ fq 34) Nevojiten më shumë veprime për të forcuar më tej të drejtën e qytetarëve për administratë të mirë. Më pak se gjysma e rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit (AP) dhe institucione të tjera të pavarura drejtuar autoriteteve publike janë zbatuar. Kjo shkallë zbatimi duhet të përmirësohet. Bashkëpunimi midis Parlamentit dhe AP duhet të forcohet më tej dhe mungesa e reagimit të organeve të administratës publike duhet të adresohet më tej. Lidhur me transparencën dhe aksesin në informacion, Komisioneri për të drejtën e informacionit raportoi një numër të qëndrueshëm prej rreth 1000 ankesash në vitin 2024, shpesh të zgjidhura pas ndërhyrjes së tij. Entet publike duhet ende të përmirësojnë pajtueshmërinë me kërkesat e transparencës dhe të jenë më të	2.b.2.d. Shtimi i seancave dëgjimore dhe shqyrtimit në komisionet parlamentare të raporteve specifike të institucioneve të pavarura, në të cilat adresohen rekomandime ndaj ekzekutivit.	Kryetari i Kuvendit; Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me parlamentin Institucione të pavarura Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve Shërbimi Legjislativ Shërbimi Integritetit European	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim	
	2.b.1.dh Rrëfja e bashkëpunimit me Ministrin e Shtetit për marrëdhëniet me Kuvendin, në zbatim të vendimit të Kuvendit nr. 134/2018 dhe vendimit të Kuvendit nr.49/2017, për të trajtuar problemin e mungesës së reagimit të organeve të administratës publike ndaj rekomandimeve të Institucioneve të pavarura.	Kryetari i Kuvendit; Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me parlamentin Institucione të pavarura Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim	

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifkisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

përgjegjshme ndaj kërkesave për akses në informacion. (Reforma në administratën Publike/ llogaridhënia e administratës, fq 26)					
ILD, KLGI, KLP dhe ILDKPKI duhet të përditësojnë procedurat e tyre të brendshme dhe të sigurojnë staf dhe burime të mjaftueshme për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e kontroleve të integritetit të magistratëve dhe kandidatëve-magjistratë në përputhje me standardet e larta të verifikimit. (Kapitulli 23/ llogaridhënia e gjyqësorit fq 29) Mungesat e burimeve njerëzore dhe financiare vazhdojnë, duke ndikuar në funksionimin e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për mbrojtjen nga Diskriminimi. (Kapitulli 23/ të drejtat e njeriut/ Promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut/ fq 34) Korniza ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale është e përshtatshme, por kapacitetet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave ende duhet të përmirësohen. Shqipëria duhet të sigurojë zbatim efektiv, duke përfshirë kapacitetin administrativ dhe buxhetor.	2.b.2. Mbeshtetja për forcimin e kapaciteteve të institucioneve të pavaruara pas raketimit me Ministrinë e Financave mbi kërkesat që ata parashirojnë në kuadër të shqyrtimit të projektligjit “për buxhetin e shtetit” si dhe për miratimin e strukturave të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Komisionet parlamentare sipas fushës së përgjegjësisë; Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve Shërbimi legjislativ	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim	

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifiktisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

Kapitulli 23/të drejtat e njeriut/mbrojtja e të dhënave personale, fq 35)				
---	--	--	--	--

III. FORCIMI I FUNKSIONIT ZGJEDHËS TË KUVENDIT					
Total 1 masë					
Gjetje/ Rekomandime të Raportit 2025 të KE për Shqipërinë lidhur me Kuvendin.	Masa konkrete	Struktura përgjegjëse	Buxheti /Efekti financiar	Afati kohor	Statusi i realizimit të masave
<i>Politizimi i emërimeve parlamentare në pozicione të larta në organet kushtetuese ose në institucionet e pavarura të krijuara me ligj mbetet një problem serioz. (Gjetjet kryesorë të Raportit/ Parlamenti, fq 4)</i> Gjatë periudhës së raportimit, Parlamenti bëri një numër emërimesh në institucione të pavarura, përfshirë Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Gjithashtu emëroi një komisioner për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe një komitet drejtues të transmetuesit publik.<i>Pritet ende emërimet e Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi. (2.1.2 Demokracia / Parlamenti, Fq 22 -23)</i> <i>Parlamenti ende nuk ka riemëruar një Avokat të Popullit dhe një Komisioner</i>	3.1 Ushtrimi i funksionit zgjedhës të Kuvendit për plotësimin e vendeve vakante në institucionet e pavarura kushtetuese apo të krijuara me ligj, sipas përcaktimeve kushtetuese dhe ligjore, kur ato krijohen, në zbatim të procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kushtetutë, ligjin specifik dhe nenin 111 të Rregullores së Kuvendit	Grupet parlamentare Komisionet parlamentare sipas fushës së përgjegjësisë; Kuvendi/Seancë Plenare; Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve Shërbimi Legjislativ Shërbimi i Integrimit European	Buxheti i Kuvendit	Nëntor 2025 - e në vijim	

<i>kundër Diskriminimit, pasi mandatet e krerëve aktualë të këtyre institucioneve skaduan përkatësisht në vitin 2022 dhe 2023, gjë që rrezikon të dobësojë seriozisht legjitimitetin e këtyre institucioneve të pavarura. (Kapitulli 23/të drejtat e njeriut/promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut, fq 34)</i> <i>Pavarësia e Autoritetit Rregullator Audio-Vizuale (AMA) ende nuk është e garantuar pasi vazhdon potenciali për ndikim politik dhe të korporatave në lidhje me procedurat e emërimit për anëtarët e bordit të AMA-s, ndërsa ka pasur mangësi në zbatimin e Kodit të Transmetimit në mediai që transmetojnë përmbajtje politike të regjistruar paraprakisht gjatë fushatave zgjedhore.</i> <i>Parregullsitë procedurale në procesin zgjedhor për një Drejtor të Përgjithshëm të RTSH në janar 2025 minuan në tej parimet e përzgjedhjes bazuar në meritë dhe rritën shqetësimet mbi pavarësinë e RTSH. Në shkurt, Parlamenti shpërndau të gjithë Këshillin Drejtues të RTSH, në shkelje të legjisllacionit në fuqi, i cili</i>					
--	--	--	--	--	--

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifiktisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

<i>lejon shkallëftikimin individual të anëtarëve të Këshillit Drejtues vetëm në varësi të garancive të procesit të rregullt ligjor. Emërimi i disa anëtarëve të Këshillit të ri, të krijuar në mars 2025, ngriti shqetësime për shkak të prejardhjes së tyre politike. Në prill 2025, bordi i ri zgjodhi Drejtorin e Përgjithshëm të RTSH. (Kapitulli 23/ të drejtat e njeriut/ Liria e shprehjes/jq 36-37)</i>				
--	--	--	--	--

OBJEKTIVI IV: FORCIMI I EFEKTIVITETIT, TRANSPARENÇËS DHE LLOGARIDHËNIES SË KUVENDIT					
TOTAL 9 MASA					
Gjetje/ Rekomandime të Raportit 2025 të KE për Shqipërinë lidhur me Kuvendin.	Masa konkrete	Struktura përgjegjëse	Buxheti/Ef ekti financiar	Afati kohor	Statusi i realizimit të masave
Parlamenti mundi të ushtrojë pushtetet e tij në një mënyrë pjesërisht efektive.Polarizimi politik, mungesa e dialogut të vërtetë politik dhe përplasjet midis shumicës në pushtet dhe pjesëve të opozitës vazhduan të ndikojnë në aktivitetin e Parlamentit. (Gjetjet kryesore të raportit: Grupkapitulli 1/ Demokracia / Parlamenti, fq 4)	4.1. Përmirësimi i dialogut politik me qëllim minimizimin e ndikimit të polarizimit politik në efektivitetin e Kuvendit përmes organizimit të takimeve periodike të Konferencës së Kryetarëve dhe/apo Kryetarit të Kuvendit dhe kryetarëve të grupeve parlamentare për diskutimin e çështjeve që kërkojnë një konsensus të gjërë.	Kryetari e Kuvendit e Konferenca e Kryetarëve Kryetarët e Grupeve parlamentare	Buxheti i Kuvendit.	Nëntor 2025 - e në vijim	
Zbatimi nga Parlamenti i kuadrit ligjor për proceset e konsultimit publik nuk çon vazhdimisht në ndjekje në kohë					

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifikkisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

<i>the transparente. Në prill të vitit 2025, Parlamenti prezantoi një mjete të ri për konsultim publik. (Grupkapitulli 1: Bazat e procesit të anëtarësimit; Demokracia / Parlamenti, fq 23).</i>	4.2 Rritja e numrit të projektligjeve dhe dokumenteve parlamentare që konsultohen në platformë në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.	Komisionet parlamentare sipas fushës së përgjegjësisë Shërbimi Legjislativ Shërbimi i Integrimit European Koordinatori i Shoqërisë civile	Buxheti i Kuvendit.	Nëntor 2025 - e në vijim	
	4.3 Zhvillimi i secancave dëgjimore publike nga komisionet e përbërshme të Kuvendit me aktorët e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, gjatë procesit të shqyrtimit dhe të vlerësimit në Kuvend të veprimtarisë së institucioneve të pavarura, duke respektuar programet dhe kalendaret e miratuara nga Kuvendi për periudhat respektive.	Komisionet parlamentare sipas fushës së përgjegjësisë Shërbimi Legjislativ Shërbimi i Integrimit European Koordinatori i Shoqërisë civile	Buxheti i Kuvendit.	Nëntor 2025 - e në vijim	
	4.4 Hartimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Standardeve Transparencës³	Shërbimi i Dokumentacionit dhe i Informacionit	Buxheti i Kuvendit. Donatorët	Nëntor 2025 - e në vijim	

³ Ish Kryetarja e Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, nënkroi në datën 29 Mars 2024, Deklaratën e angazhimit të Kuvendit të Shqipërisë mbi zbatimin e Standardeve të Transparencës, të cilat janë hartuar nga Kuvendi, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të medias, me mbështetjen e Institutit Demokratik Amerikan (NDI). <https://www.parlament.ch/lajme/5114bcf7-6500-4f3d-860e-e709b79c3457>

	4.5 Hartimi, miratimi dhe publikimi i Raportit të Kuvendit mbi pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit për vitin 2025, brenda muajit mars 2026.	Shërbimet e Kuvendit Koordinatori i Shoqërisë civile	Buxheti i Kuvendit.	Nëntor 2025 - e në vijim	
	4.6 Zbatimi të plotë të sistemit të E-Legjislacionit që do të integrojë sistemet e të gjitha institucioneve të përfshira në procesin ligjberës si dhe forcimin e kapaciteteve administrative të Kuvendit nëpërmjet trajnimeve për të përballuar rrëzën e përgjegjësiive për çështjet e transparencës që dalin nga procesi i anëtarësimit brenda 2024-2028.	Shërbimi Legjislativ Shërbimi i Integrimit European Shërbimi i IT	Buxheti i Kuvendit.	Nëntor 2025 - e në vijim	
	4.7 Ndryshimi i Kodit të Sjelljes së deputetëve, duke parashikuar detyrimin që takimet e deputetëve me OSHC-të dhe lobistët të bëhen vetëm me ata që janë të regjistruar në Regjistrin e OSHC-ve dhe Regjistrin e Lobistëve të krijuar dhe përditësuar nga Kuvendi në përputhje me përcaktimet e	Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin Seanca Plenare Shërbimi Legjislativ	Buxheti i Kuvendit.	Nëntor 2025 - e në vijim	

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifiktisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë 2025

Komisioni i Përhershëm Parlamentar për Çështjet Evropiane i Parlamentit dhe mendimet e tij mbi projekt-pozicionet negociuese mbi Grupkapitujt negociuese dhe në vitin 2024 shqyrtoi 13 projektligje që synojnë përafrimin me acquis të BE-së. Ky Komision është bashkuar në një Komision të ri për Çështjet Evropiane dhe të Jashtme, i cili nuk kryesohet më nga opozita, pavarësisht konsensusit të gjerë ndërpartiak për pranimin në BE. Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian ka vazhduar aktivitetet e tij, duke përfshirë shqyrtimin e dokumenteve kryesore, të tilla si udhërrëfyesit për hapjen e negociatave të pranimit mbi grupin themelor dhe rritjen e ndërgjegjësimit për përmbushjen e detyrimeve të pranimit në BE.	vendimeve të Komisionit të datës 31 janar 2018 për Kodin e Sjelljes për Anëtarët e Komisionit Evropian, neni 7, si dhe publikimin e minutave të mbledhjes.				
	4.8 Zhvillimi i seancave dëgjimore të Komisionit për Europën dhe Punët e Jashtme mbi monitorimin e procesit të negociatave	Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme Sekretariati Teknik i Komisionit	Buxheti i Kuvendit.	Nëntor 2025 - e në vijim	
Komunikimi mbi integrimin evropian është përqendruar në hapjen e grupkapitujve negociues dhe në përfitimet e Planit të Rritjes. <i>Duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të</i>					
	4.9 Organizimi i takimeve periodike dhe ndërgjegjëseve të KKIE mbi monitorimin e procesit të negociatave në kapituj të ndryshëm.	KKIE Sekretariai Teknik i KKIE	Buxheti i Kuvendit.	Nëntor 2025 - e në vijim	

Draft Plan Veprimi për adresimin e rekomandimeve që i adresohen specifiktisht Kuvendit, në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë 2025

	<i>nëpërmjet publikimit në faqen e Kuvendit të:</i> i) vendimeve dhe ii) procesverbalit të mbledhjes si edhe iii) statistikave periodike për zbatimin e Kodit të Sjelljes së deputetëve.				
--	--	--	--	--	--